



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësia org. Org.Jedinita Org./Unit	5P-02	No i Prot. Broj Prot. Prot. No.	4569-2/24
No i Faqeve Br. Stranica No. Pages	-04-	Data: Datum: Date:	28-09-25
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	27.12.2024
REFERENC-Ë:	24/4569/MMPHI
PËR/ZA/TO:	Kompania "Graniti" Sh.p.k. Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për pëlqim mjedisor të dërguar nga kompania e juaj me nr.prot.: 24/4569/453/DMMU dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Refuzim të kërkesës së Kompanisë "Graniti" Sh.p.k. Istog - shfrytëzimi, thërmimi dhe seperimi i gurit gëlqeror në vendburimin në Lubozhdë - Cercë, Istog (zgjerimi i fushës eksploatuese).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General
Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Refuzim i kërkesës së kompanisë "Granit" Sh.p.k. Istog, e cila ka aplikuar për pëlqim mjedisor për shfrytëzimin dhe thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror (zgjerim i fushës eksploaturese) në ngastrat kadastrale Nr. P-70806031-00077-86 dhe P-70806057-00028-90 zona kadastrale Lubizhdë-Cercë komuna e Istogut.

Faqe 2 nga 4

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://ëëë.ks-gov.net/mumph>, E-mail: zsp.mumph@ks-gov.net



A r s y e t i m

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Granit" Sh.p.k. Istog, e cila ka aplikuar për shfrytëzimin dhe thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror (zgjerim i fushës eksploatuese) në Lubizhdë-Cercë komuna e Istogut, është konstatuar mungon dokumentacioni si në vijim:

- Pëlqimi i komunës nuk është i qartë se a lejohet apo jo ushtrimi i kësej veprimtaritë nga komuna e Istogut, për operatorin dhe parcelën në fjalë;
- Vlera investuese e projektit në formë tabelare;

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, Paragrafi 2, 3 dhe 4, Kompanisë "Granit" Sh.p.k. Istog, me datën 16.08.2024 është dërguar njoftimi për plotësim të dokumentacionit.

Dokumentet e kërkuara janë sjellë në afatin e përcaktuar ligjor.

Komisioni për vlerësim të raporteve të VNM-së ka shqyrtuar kërkesën, raportin e VNM-së, dokumentacionin përcjellës të kompanisë "Granit" Sh.p.k. Istog, bazuar në dokumentacioni shtese të sjellur nga kompania "Granit" Sh.p.k. Istog është konstatuar se në pëlqim komunal të Istogut për ngastrën P-70806057-00028-90, zk. Cerrcë, lloji i shfrytëzimit të parcelës është "Pyjor", kualiteti i klasës është "Malë i klasit tretë", kurse në ngastrën P-70806031-00077-86 zk. Lubozhdë lloji i shfrytëzimit të parcelës është "Pyjor", kualiteti i klasës është "Malë i klasit tretë", komuna nuk e ka specifikuar se a lejohet ushtrimi i veprimtarisë, gjithashtu vlera investuese e projektit nuk përputhet me vlerën investuese të paraqitur në formularin e kërkesës për VNM.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr vendim për **Refuzimin** e kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë "Granit" Sh.p.k. Istog, e cila ka aplikuar për pëlqim mjedisor për shfrytëzimin dhe thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror (zgjerim i fushës eksploatuese) në ngastrat kadastrale Nr. P-70806031-00077-86 dhe P-70806057-00028-90 zona kadastrale Lubizhdë-Cercë komuna e Istogut.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/4569/ - ZSP/ /24 datë: 27.12.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Kabinetit të Ministrit
5. Divizionit për komunikim me publikun
6. Arkivit të MMPHI
7. Komunës së Istogut



UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI